

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5760
E mërkurë, 24 prill 2019
çmimi 0.40 €

Qeveria ka miratuar
tri nisma për njohje
të patentëshoferëve
jashtë vendit | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



**A PO SHNDËRROHET
NDËRTIMTARIA NË
RREZIKUESIN MË
TË MADH TË JETËS SË
PUNËTORËVE?! | F. 6**

Nga: KMDLNj

**LIROHEN TË KTHYERIT NGA
SIRIA NË KOSOVË, 32 GRA
NËN HETIM | F. 7**

**BYTYQI KËRKON NDARJE TË
BUXHETIT PËR PENSIONIN
INVALIDOR PËR PERSONELIN
EDUKATIVO-ARSIMOR | F. 3**

EKONOMI

**KOMISIONI I GRANTEVE
APROVON FINANCIMIN
KOMUNAL PËR VITIN
2020 - 2022 | F. 9**

**POSTA NXJERR PULLA
POSTARE ME VEPRAT E
ARTISTIT ESAT VALLA | F. 9**

KULTURË

**BORGES: LIBRI PËRHERË
RUAN NJË SHENJTËRIM | F. 14-15**

SPORT

**KOMITETI EKZEKUTIV
I FFK-SË VLERËSON
POZITIVISHT GARAT E
KAMPIONATIT TË KOSOVËS | F. 16**



FLET PËR "EPOKËN E RE", SADRI FERATI | FAQE 4-5

Në vjeshtë do të ketë zgjedhje të parakohshme

Ish-deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sadri Ferati, ka thënë se zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit vazhdojnë të jenë problemet kryesore në Kosovë. Ai ka vlerësuar se qeverisja aktuale ka shumë probleme dhe nuk po merret me shqetësimet e qytetarëve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ferati ka thënë se është në interes të vendit që të ketë zgjedhje të reja. Ai ka pohuar se në vjeshtë do të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare. Ish-ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal ka folur edhe për zgjedhjet lokale në veri, me ç'rast ka thënë se pjesëmarrja e Listës Serbe në këtë proces tregon se dorëheqjet kanë qenë të ngutshme. Sa i përket vazhdimit të dialogut me Serbinë, Ferati ka thënë se ky proces është sfidues, prandaj kërkon konsensus politik

Pacolli: Liberalizimi i vizave këtë vit, nuk ka tërheqje të njohjeve | FAQE 3

Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, beson se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë në këtë vit. Ai nuk beson se zgjedhjet në BE do të mund ta zvarrisin më shumë këtë proces. Në raportimin e tij para Komisionit për Integritet Evropian, Pacolli ka hedhur poshtë pretendimet e Serbisë për tërheqje të njohjeve. Ai ka treguar se presidentët e disa shteteve për të cilat Serbia pretendon se e kanë tërhequr njohjen do ta vizitojnë shumë shpejt Kosovën



**Ulqini
prezanton
ofertën
turistike për
pushuesit
nga Kosova | FAQE 8**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Partia Demokratike krijon koalicionin opozitar

. TIRANË, 23 PRILL - Janë 8 parti opozitare që nënshkruan marrëveshje individuale me Partinë Demokratike për krijimin e koalicionit opozitar për zgjedhjet.

LSI-ja, për herë të dytë pas marrëveshjes në 2009 me Sali Berishën, firmos sërish bashkëpunimin me demokratët, tashmë në opozitë dhe me kryetar Lulzim Bashën. "Nuk do të ketë zgjedhje farsë në Shqipëri pa u ndëshkuar krimi elektoral, pa u ndëshkuar dhe pa u vënë përpara përgjegjësisë Edi Rama dhe



bashkëpunëtorët e tij në këtë krim elektoral, duke nisur me Vangjush Dakon dhe Damian

Gjiknurin", deklaroi Basha. Ndërsa Monika Kryemadhi u shpreh: "Këtu nuk është prob-

lemi Edi Rama si individ, por Edi Rama si fenomen. Po flasim për Edi Ramën i cili është telekomanda e kimit të organizuar shqiptar dhe ndërkom-bëtar".

Në ditën kur Partia Demokratike dhe aleatët e saj vulosën vendimin për të mos u futur në zgjedhje me Edi Ramën kryeministër, parti të tjera u regjistruan për t'u bërë pjesë e garës vendore. Më e reja, Bindja Demokratike e Astrit Patozit.

"Gjeneza e të keqes ku ndodhemi janë zgjedhjet falsë të diktuar nga

krimi. Prandaj, natyrisht nuk do të ketë më as opozitë falsë", tha Basha.

Me radhë, aleatët e demokratëve firmosën njëri pas tjetrit dokumentin me 10 pika, ku pranuan se nuk do të futen në zgjedhje pa u plotësuar kushti për një proces të lirë dhe të ndershëm, të cilat duhet të organizohen nga një qeveri transitore.

Reforma zgjedhore dhe ajo në drejtësi pritet të jenë në mandatin e qeverisë transitore e deri në atë ditë opozita pritet të përshkallëzojë qëndrimin për të pamundësuar nëse do të mbahen pa të.

Veseli, letër Parlamentit Evropian dhe QUINT-it për krimet serbe

Në letrën që u ka dërguar Parlamentit Evropian dhe vendeve të QUINT-it për krimet dhe gjenocidin që Serbia ka kryer në Kosovë gjatë luftës së fundit 1998-1999, kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se është e njohur ndërkombëtarisht se nën regjimin brutal të Sllobodan Millosheviqit, shqiptarët në Kosovë ishin viktimat dhe objektivi i një dhune sistematike



Prishtinë, 23 prill - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, iu ka dërguar letër Parlamentit Evropian dhe vendeve të QUINT-it për krimet dhe gjenocidin që Serbia ka kryer në Kosovë gjatë luftës së fundit 1998-1999.

Veseli ka përmendur masakrat dhe krimet e shumta që Serbia ka kryer në Kosovë, duke thënë se është e njohur ndërkombëtarisht se nën regjimin brutal të Sllobodan Millosheviqit, shqiptarët në Kosovë ishin viktimat dhe objektivi i një dhune sistematike. Si pasojë, ka shkruar Veseli, rreth një milion kosovarë, më shumë se gjysma e popullsisë, janë detyruar të largohen nga Kosova, me një gjysmë milioni të tjerë të zhvendosur brenda vendit. "Në total, rreth 90 për qind e popullsisë etnike shqiptare u bënë

refugjatë ose persona të zhvendosur. 13.535 u vranë. Në mesin e tyre ishin 1230 fëmijë, duke përfshirë bebet dhe fëmijë tjerë të vegjël", thuhet mes tjerash në letrën e kryeparlamentarit Veseli dërguar në Strasburg. Ai ka përmendur edhe fatin ende të pazgjidhur për mijëra persona të zhdukur. "Gjatë dhjetë vjetëve të ekzistencës së saj, Kosova ka treguar se është një vend paqedashës dhe që në mënyrë aktive kërkon marrëdhënie pozitive me të gjithë fqinjët e saj, duke përfshirë këtu Serbinë. Megjithatë, duhet të them se ende duhet bërë shumë për të mundësuar shërimin, dhe një pjesë e këtij shërimi është pranimi i së vërtetës", thuhet tutje në letrën e kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli. Kryekuvendari Veseli

u ka kërkuar të gjitha vendeve mike që të nxjerrin nga një rezolutë përmes së cilës konfirmohet e vërteta e krimeve serbe në Kosovë. "Në emër të Kuvendit të Kosovës, dëshiroj t'u ftoj juve

dhe kolegët tuaj për të bërë të mundur njohjen formale e padrejtësisë historike që është bërë kundër popullit tim. Kjo mund të bëhet përmes një rezolute që vë në dukje dhe dënon

krimet kundër njerëzimit që kanë ndodhur në Kosovë", thuhet në letrën e Veselit. Një letër e tillë, ditë më parë nga kryetari i Kuvendit të Kosovës i është dërguar edhe Kongresit amerikan.

Partia e Patozit merr pjesë në zgjedhje

TIRANË, 23 PRILL - Astrit Patozi zyrtarizoi "Bindjen Demokratike" duke e regjistruar në Gjykatën e Tiranës dhe në KQZ nga ku kanë dorëzuar edhe 1000 firma më shumë nga 3000 që kërkohen.

Tri janë prioritetet e "Bindjes Demokratike": zgjedhje të lira dhe të ndershme përmes ndryshimit të sistemit zgjedhor; betejë kundër korrupsionit politik dhe atij shtetëror pasi vendi nuk mund të ketë kurrë barazi sociale; dhe zhvillim të

qëndrueshëm ekonomik. Për herë të parë, paraditën e të martës është zbuluar edhe logojja e kësaj force politike me ngjashmëri në ngjyrë me atë të PD-së dhe përfaqësi grafikisht. Në komunikatën e parë për mediat, "Bindja Demokratike" thotë se "nismëtarët vendosën të mandatojnë një bord të përkohshëm, i cili do të përfaqësojë partinë deri në ngritjen dhe zgjedhjen e forumeve drejtuese të saj, sipas statutit".

"Bindja Demokratike është dhe do të jetë një ofertë serioze dhe tërësisht e pavarur, sa herë që të ketë zgjedhje në Shqipëri. Bindja Demokratike është frymë dhe alternativë e re, në një shoqëri, ku monopoli partitokratik po vret konkurrencën dhe ka kufizuar lirinë e zgjedhjes për qytetarët. Ne jemi të bindur se Shqipëria sot po vuan pasojat e një polarizimi politik, që e ka zanafillën te vrasja e demokracisë brenda dy partive



të mëdha dhe të konsolidimi i një sistemi mbytës, që garanton palët rivale për

mosndëshkueshmëri dhe mbijetesë politike, kundër çdo projekti të ri", u shpreh Patozi.

Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka raportuar para Komisionit për Integritet Evropian

Pacolli: Liberalizimi i vizave këtë vit, nuk ka tërheqje të njohjeve

Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, beson se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë në këtë vit. Ai nuk beson se zgjedhjet në BE do të mund ta zvarrisin më shumë këtë proces. Në raportimin para Komisionit për Integritet Evropian, Pacolli ka hedhur poshtë pretendimet e Serbisë për tërheqje të njohjeve. Ai ka treguar se presidentët e disa shteteve për të cilat Serbia pretendon se e kanë tërhequr njohjen do ta vizitojnë shumë shpejt Kosovën

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 PRILL - Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, është shprehur i bindur të martën se liberalizimi i vizave për Kosovën do të ndodhë këtë vit. Gjatë raportimit para Komisionit për Integritet Evropian, ai ka thënë se nuk beson se zgjedhjet në BE do të sjellin ndonjë ndryshim i cili do ta pengonte këtë proces. "Po e them këtë me përgjegjësi se ky vit është vendimtar për Kosovën. Ne do të kemi viza gjatë këtij viti. Shpresoj se zgjedhjet evropiane të jenë në gjendje ta forcojnë idenë e hapjes së Evropës për kosovarët dhe, sa i përçjell zhvillimet në fushat e elektorale, nuk do të ketë ndonjë ndryshim të madh ideologjikisht. Kur e them këtë, e dimë se cilat parti e kanë mbështetur Kosovën. Prandaj konfigurimi do të jetë pothuajse i njëjtë", ka deklaruar Pacolli. Ai ka treguar

edhe për aktivitetin që ka zhvilluar me homologët e vet evropianë për këtë çështje. "Në detyrën e ministrit të Punëve të Jashtme kam zhvilluar takime të shumta me homologët e mi të vendeve anëtare të BE-së, të cilëve vazhdimisht ua kam shpjeguar të arriturat e Kosovës në këtë proces dhe izolimin e Kosovës në këtë proces", ka deklaruar ai. Para këtij komisioni, ministri Pacolli ka raportuar edhe për obligimet që Ministria e Punëve të Jashtme ka në raport me MSA-në. "Një lloj sfide është zbatimi i dispozitave që dalin nga kjo marrëveshje si rrjedhojë e pozicionit të BE-së karshi Kosovës. Duhet të jemi realë, qysh nga pikënisja, versioni i dialogut politik i MSA-së që ka Kosova dallon nga vendet e rajonit për shkak të mosnjohjes së Kosovës nga pesë shtetet anëtare të BE-së", është shprehur ai. Shefi i diplomacisë së Kosovës u është përgjigjur edhe pretendimeve të anëtarëve të këtij komisioni për tërheqjen e njohjeve. Pacolli ka treguar se pre-

tendimet e Serbisë për tërheqje të njohjeve shumë shpejt do të demantohen nga liderët e atyre shteteve të cilët do ta vizitojnë Kosovën. "Ju do të shihni se bash për këto shtete për të cilat është folur se kanë bërë tërheqje të njohjeve do të kemi vizita të burrështetasve të presidenteve të këtyre shteteve. Shumë shpejt neve do të na vizitojnë edhe presidenti i Guinea Bisaut dhe presidenti i Nigerisë. Është e vërtetë se kanë ardhur disa

njerëz në Beograd dhe disa përfaqësues të ministrive të ndryshme të shteteve të ndryshme", ka thënë Pacolli, duke përmendur edhe numrin e njohjeve. "Kemi 116 njohje. Kemi mbi 110 nota verbale për njohje. Gjashtë nota verbale nuk kanë ardhur për arsye se, sipas rregullave, nuk ka nevojë nota verbale", ka treguar Pacolli. Deputetët e subjekteve opozitare e kanë kritikuar diplomacinë e Kosovës, ndërsa kryetarja e

Komisionit për Integritet Evropian, deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka shprehur shqetësimin e saj për pretendimet e diplomacisë serbe për tërheqjen e njohjeve. Shefi i diplomacisë i ka njoftuar deputetët edhe për angazhimin e tij në marrëdhëniet ndërkombe-tare dhe për hapjen e ambasadave të reja në shtetet të ndryshme. Sipas tij, Republika e Kosovës shumë shpejt pritet t'i hapë ambasadat në disa shtete.

Bytyqi kërkon ndarje të buxhetit për pensionin invalidor për personelin edukativo-arsimor

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 PRILL - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të martën në takim të Komisionit të Grantëve, ku është bërë shqyrtimi i propozimit të granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2020, me ç'rast ka paraqitur politikën e reja arsimore, për të cilat edhe ka kërkuar mbështetjen financiare. Duke shprehur shqetësimin sa i përket mungesës së legjislacionit në fuqi, ministri Bytyqi ka paraqitur kërkesën e Ministrisë së Arsimit për ndarje të buxhetit, për rregullimin e çështjes së pensionit invalidor për personelin edukativo-arsimor.



Ministri Bytyqi ka kërkuar mbështetjen financiare për ofrimin e shtatëdhjetë për qind të pagës bazë për mësimit të rëndësishëm, numri i të cilëve është mbi 300 dhe lirim nga mësimit të rëndësishëm aktive dhe në të njëjtën kohë angazhimin e

mësimit të rinj në vendet përkatëse të punës. Përveç planifikimit konform legjislacionit, ka thënë ministri Bytyqi, "kemi planifikuar edhe një varg politikash të reja të cilat lidhen me përmirësimin e gjendjes në arsim dhe ngritjen e cilësisë, e që janë kërkesa për

100 asistentë shtesë për fëmijët me nevojë të veçanta, realizimi i praktikës profesionale për nxënësit e arsimit dhe aftësimin profesional dhe pagesën e orës së kujdestarisë, me qëllim të parandalimit të dukurive devijuese të nxënësit". Duke pasur parasysh pagesën e pagave jubilarë të cilat realizohen përmes proceseve gjyqësore, ministri Bytyqi ka kërkuar që kostoja për pagat jubilarë të përfshihet në gratin specifik të arsimit. Po ashtu, edhe pagat për mësimit të rëndësishëm dhe gjuhës së dytë obligative, pagat e zëvendësuesve për bashkëpunim me ndërmarrje për shkollat e mesme profesionale, si dhe pagat e këshilltarëve të karrierës, me të cilët synohet orientimi dhe përgatitja e nxënësit për orientimin në

karrierë, janë përfshirë në politikën e reja të Ministrisë së Arsimit. Në fund të takimit, ministri Bytyqi ka kërkuar ndarje të buxhetit për komuna në funksion të rritjes së përfshirjes së fëmijëve edhe me pesë për qind të grupmoshëve 6 muaj deri në 5 vjeç dhe fillimin e pilotimit të mësimit tërëditor në 29 shkollë në nivel vendi. Duke pasur në konsideratë të plotë kërkesat dhe nevojat e shumta të komunave, në secilin segment dhe mundësitë buxhetore të shtetit dhe për faktin që arsimit është i të gjithëve, ministri ka kërkuar që në vijim të takimeve që kanë të bëjnë me planifikime buxhetore, të gjejnë mbështetje të plotë të gjitha këto politika të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Flet për "Epokën e re", Sadri Ferati

Në vjeshtë do të ketë zgj



Ish-deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sadri Ferati, ka thënë se zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit vazhdojnë të jenë problemet kryesore në Kosovë. Ai ka vlerësuar se qeverisja aktuale ka shumë probleme dhe nuk po merret me shqetësimet e qytetarëve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ferati ka thënë se është në interes të vendit që të ketë zgjedhje të reja. Ai ka pohuar se në vjeshtë do të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare. Ish-ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal ka folur edhe për zgjedhjet lokale në veri, me ç'rast ka thënë se pjesëmarrja e Listës Serbe në këtë proces tregon se dorëheqjet kanë qenë të ngutshme. Sa i përket vazhdimin të dialogut me Serbinë, Ferati ka thënë se ky proces është sfidues, prandaj kërkon konsensus politik

merret me shqetësimet e qytetarëve. Në këtë kontekst, Ferati ka deklaruar se është në interes të Kosovës që të ketë zgjedhje të reja. Ai ka thënë se në vjeshtë do të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare. Ferati ka pohuar se zgjedhjet do të mbahen në shtator ose në tetor. "Unë mendoj se do të ketë zgjedhje të parakohshme dhe është në interes të Kosovës që të ketë zgjedhje. Besoj se do të krijohet klima për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve. Pres që zgjedhjet e parakohshme të mbahen në vjeshtë, do të thotë në shtator ose në tetor", ka theksuar Ferati.

"Epoka e re": Z. Ferati, si e vlerësoni ecurinë e procesit zgjedhor brenda Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)?

Ferati: Është një proces normal të cilit i kanë paraprirë vendimet e organeve përkatëse. Aktualisht nëpër degë është duke u zhvilluar një garë në një konkurrencë. Shpresojmë se kjo do të vazhdojë

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 23 PRILL - Zyrtari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sadri Ferati, ka thënë të martën se procesi zgjedhor në këtë parti është duke u zhvilluar në frymë pozitive. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se zgjedhjet do t'i shërbejnë demokracisë dhe fuqizimit të brendshëm. "Aktualisht nëpër degë është duke u zhvilluar një garë në një konkurrencë. Shpresojmë se kjo do të vazhdojë

edhe më tutje në mënyrë që t'i shërbejë demokracisë dhe fuqizimit të brendshëm. Konsideroj se gjithçka është duke shkuar në drejtim pozitiv", ka deklaruar Ferati, duke bërë me dije se nuk do të kandidojë për kryetar të Degës së LDK-së në Mitrovicë. Ai nuk ka dashur ta komentojë garën për të parin e LDK-së, duke thënë se është ende herët të flitet për një gjë të tillë.

Ish-ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, ka folur edhe për zgjedhjet lokale në veri, me ç'rast ka thënë se

pjesëmarrja e Listës Serbe në këtë proces tregon se dorëheqjet kanë qenë të ngutshme. Kurse sa i përket vazhdimin të dialogut me Serbinë, Ferati ka thënë se ky proces është sfidues, prandaj kërkon konsensus politik. "Është pak e dhimbshme sa i përket përfaqësimit të shtetit që nuk po arrihet një konsensus që të jenë të gjitha forcat aty kur është në pyetje çështja e dialogut apo të tjerat ngaqë ka mungesë të besimit që është kultivuar nga e kaluara. Tash për tash dialogu ka ngecur. Dialogu si i tillë është sfidues dhe dëshiroj që të jenë të

gjitha partitë në tryezë kur është në pyetje fati i shtetit", është shprehur ai.

Ferati ka vlerësuar se takimi i Berlinit përfundimisht nuk do të qartësojë të ardhmen e dialogut por, sipas tij, mund të jetë një nxitje për të sjellë diçka pozitive. Në këtë intervistë ish-deputeti i LDK-së, Sadri Ferati, ka folur edhe për proceset e tjera në vend, duke thënë se zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit vazhdojnë të jenë problemet kryesore në Kosovë. Ai ka vlerësuar se qeverisja aktuale ka shumë probleme dhe nuk po

edhje të parakohshme

medie deklarata e tyre se kanë apo nuk kanë ambicie. Një numër i madh i tyre kanë thënë se do të shikojnë më vonë, kurse disa edhe nuk e kanë përjashtuar mundësinë për të qenë kandidat. Mirëpo është herët të thuhet cili është favoriti.

"Epoka e re": Ju do të jeni pjesë e procesit zgjedhor?

Ferati: Tash për tash nuk jam, sepse dega e Mitrovicës ende nuk i ka filluar zgjedhjet. Kur të merret vendimi për të pasur zgjedhje në Mitrovicë atëherë do të shikoj.

"Epoka e re": Do të kandidoni për kryetar të Degës së LDK-së në Mitrovicë?

Ferati: Jo, nuk do të jem kandidat për kryetar të Degës së LDK-së në Mitrovicë.

"Epoka e re": Z. Ferati, si i komentoni zhvillimet politike në vendin tonë?

Ferati: Sipas mendimit tim, është një qeverisje me shumë probleme. Më shumë merren me tema politike dhe më pak flitet për shqetësimet e qytetarëve. Kosova ende i ka ato të metat e mëdha siç janë: zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit. Këto janë pikat më të dobëta dhe mendoj se kjo qeveri ende nuk ia ka dalë për të pasur ndonjë ndryshim të dukshëm nga gjendja që ka qenë më herët. Asnjëherë gjendja nuk ka qenë e mirë, por tash kam përshtypjen se nuk po shihen as tentime serioze që të ndryshohet diçka në këtë drejtim. Nuk po shoh se ka qartësim dhe vullnet për të pasur sukses dhe ndryshim në këto pika që i përmenda më lart.

"Epoka e re": Si e keni parë rolin e opozitës dhe të LDK-së në veçanti?

Ferati: Partitë opozitare i kanë shfrytëzuar mundësitë e tyre për të treguar se janë opozitë edhe në kuptimin për të mos u pajtuar me shumë çështje dhe në këtë drejtim e shoh edhe rolin e LDK-së. Është pak e dhimbshme sa i përket përfaqësimit të shtetit që nuk po arrihet një konsensus që të jenë të gjitha forcat aty kur është në pyetje çështja e dialogut apo të tjerat ngaqë ka mungesë të besimit që është kultivuar nga e kaluara. Përndryshe, mendoj se opozita ka një komunikim të mirë me qytetarët dhe para tyre po i reflekton të gjitha vërejtjet dhe qëndrimet. Është një opozitë e mirorganizuar.

"Epoka e re": Në mungesë të arritjes së këtij konsensusi për të cilin ju po flisni, cila do të jetë rrjedha e procesit të dialogut Kosovë - Serbi?

Ferati: Tash për tash dialogu ka

ngecur. Dëshiroj që të jenë të gjitha partitë në tryezë kur është në pyetje fati i shtetit.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh rrethanat aktuale, sa ka mundësi të ndodhë një gjë e tillë?

Ferati: Fatkeqësisht, sa unë po shoh, mundësitë janë të vogla dhe kjo është për keqardhje.

"Epoka e re": Eventualisht mund të presim ndryshim të qëndrimit të LDK-së për t'u bërë pjesë e dialogut?

Ferati: LDK-ja ka thënë se nuk do të jetë pjesë e dialogut në këtë format dhe me këtë qasje që ka presidenti dhe partitë në pushtet. Këta sillen sikur thonë se 'kur më duhesh eja, por nëse nuk më duhesh, nuk të përfilli'. Prandaj LDK-ja nuk është e interesuar të marrë pjesë në këtë format dhe me këtë qasje.

"Epoka e re": Samiti i Berlinit që do të mbahet më 29 prill. A prisni ta qartësojë të ardhmen e dialogut ndërmjet dy vendeve?

Ferati: Nuk pres që takimi i Berlinit përfundimisht ta qartësojë të ardhmen e dialogut, megjithatë mund të jetë një nxitje dhe mund të ketë diçka pozitive.

"Epoka e re": Po sa iu përket zgjedhjeve të jashtëzakonshme në veri, cilat janë pritjet e juaja?

Ferati: Kjo është një mundësi që të shihet edhe një herë se dorëheqjet e kryetareve në veri kanë qenë të ngutshme që kanë çuar në rrugë qorre. Është bërë mirë që janë shpallur zgjedhjet dhe tani mbetet të shihet nëse Lista Serbe do t'i bojkotojë apo jo, kurse rezultati le të jetë pjesë e vullnetit të qytetarëve. Mendoj se kjo është edhe një dëshmi se dalja në zgjedhje e Listës Serbe është pranim automatikisht se

ata janë nxituar dhe kanë dashur t'i shantazhojnë institucionet e Kosovës me dorëheqjet e tyre.

"Epoka e re": Z. Ferati, opozita që nga formimi i kësaj qeverie ka kërkuar zgjedhje të parakohshme, por pozita pretendon se mund ta çojë deri në fund mandatin. Do të ketë zgjedhje të parakohshme gjatë këtij viti?

Ferati: Unë mendoj se do të ketë zgjedhje të parakohshme dhe është në interes të Kosovës që të ketë zgjedhje. Besoj se do të krijohet klima për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve.

"Epoka e re": Kur saktësisht parashihni mbajtjen e këtyre zgjedhjeve?

Ferati: Pres që zgjedhjet e parakohshme të mbahen në vjeshtë, do të thotë në shtator ose në tetor.

Certifikohen pjesëtarët e FSK-së për përdorim të pajisjeve detektuese

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Në kazermën "Evropianët e rinj" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile në Pomezatin, nga data 8 deri më 19 prill është zhvilluar trajnimi për përdorimin e pajisjeve të reja detektuese të rrezeve: Alfa, Beta dhe Gama, si dhe për përdorimin dhe ndërtimin e stacionit të dekontaminimit në masiv

nga materiet e rrezikshme, mbajtur nga instruktorë të ekipit Diitra të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 37 pjesëtarë, ku katër prej tyre, përfaqësues të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me komandanin e Kompanisë së Kimisë, majorin Florenc Veliu. Me

këtë rast, kompania e MKAB-së e FSK-së ka përfutur njohuri të reja duke e rritur edhe më tutje nivelin operacional. Rendësi e veçantë e këtij trajnimi ishte edhe shkëmbimi i përvojave në mes të njësive së kimistëve nga Republika e Shqipërisë dhe Kompanisë së MKAB-së nga Republika e Kosovës.



edhe më tutje në mënyrë që t'i shërbejë demokracisë dhe fuqizimit të brendshëm. Konsideroj se gjithçka është duke shkuar në drejtim pozitiv.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet e juaja nga këto zgjedhje? Kush duhet ta drejtojë LDK-në?

Ferati: Nuk e di meqë ende nuk dihet se kush ka ambicie dhe kush do të konkurrojë. Shumë do të varet nga delegatët dhe se si do të shkojë rrjedha nëpër degë. Pastaj kur të vijë pjesa finale, do të mund të parashikonim dhe të qartësonim diçka. Tash për tash nuk flitet shumë për liderin e ardhshëm të LDK-së, por vetëm në nivel të degëve. Kështu që, është herët për të biseduar për këtë çështje.

"Epoka e re": Megjithatë, në opinion janë përfolur disa emra të cilët synojnë postin e kryetarit të LDK-së siç janë: Isa Mustafa, Lutfi Haziri, Fatmir Sejdiu dhe Vjosa Osmani.

Ferati: I kemi dëgjuar nëpër

Haradinaj përkujton 74-vjetorin e masakrës së Tivarit

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - "Pa ndëshkimin e atyre që urdhëruan dhe kryen krimet, ato mund të përsëriten kurdo. Së këndejmi, është detyrë e shtetit të Kosovës që t'i njohë dhe t'i trajtojë ata që kaluan ferrin e Tivarit, pas vdekjes, si martirë", kështu ka deklaruar kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në akademinë përkujtimore me rastin e 74-vjetorit të masakrës së Tivarit.

Haradinaj ka thënë se masakra e Tivarit është ndër ngjarjet më të dhimbshme dhe një ngjarje ndaj së cilës është bërë më së shumti padrejtësi në gjithë këto vite. "Dje janë mbushur 74 vjet

nga masakra e Tivarit, ku nën ndikimin e hegjemonizmit serb u mobilizuan dhunshëm 13 335 shqiptarë, të shpallur si robër luftime, një pjesë e të cilët pastaj u vranë dhe u hodhën në varreza masive, prej të cilëve shumica djem e burra të Kosovës. Pse duhet shënuar kjo ditë tragjike dhe përse duhet t'i ndërmarrim veprimet e duhura si institucione të shtetit, jo vetëm të diskutojmë, por edhe ta nxjerrim në dritë të drejtën? Sepse ky krim makabër është mohuar gjatë dhe këta njerëz e pasardhësit e tyre kurrë nuk kanë marrë një përgjigje pse u vranë?", ka deklaruar Haradinaj.



Policia shënoi Ditën e Tokës me disa aktivitete

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës, Policia e Kosovës ka planifikuar disa aktivitete policore në shenjë të shënimit në mënyrë simbolike të kësaj dite, e cila vlerësohet mjaft e rëndësishme për planetin tokë dhe mbarë njerëzimin. Këto aktivitete janë realizuar në disa rajone policore ku, përveç menaxhmentit të lartë të PK-së në krye me drejtorin e përgjithshëm Rashit Qalaj, janë angazhuar edhe zyrtarë të profileve të ndryshme, përfshirë njësitet kufitare me barkë, të cilët kanë marrë pjesë në dhënien e kontributit të tyre te liqeni i Badovcit.

Policia e Kosovës, përveç këtyre aktiviteteve policore, ka qenë e angazhuar edhe për ofrimin e asistencës policore në aspektin

e sigurisë kryesisht ndaj të gjitha institucioneve, agjencive dhe organizatave të ndryshme të cilat kanë realizuar aktivitete në shënimin e kësaj dite.

Policia e Kosovës ka bërë me dije se do të vazhdojë të kontribuojë për ndërgjegjësimin për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes së lartë të ajrit, ujit e tokës në vendin tonë. "Qëllimi i kësaj date mbetet reflektimi në mbrojtjen fundamentale të planetit Tokë dhe të gjitha resurseve të saj nga ndotja dhe degradimi i saj, ku një rol të rëndësishëm ka edhe Policia e Kosovës e cila do të vazhdojë ndërmarrjen e veprimeve policore drejt parandalimit dhe bashkëpunimit me të gjitha institucionet relevante të kësaj natyre", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.



Liderët e institucioneve thonë se komuniteti turk gjithmonë ka luajtur rol konstruktiv

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Me rastin e shënimit të Ditës së Komunitetit Turk të Kosovës, presidenti Hashim Thaçi ka shprehur mirënjohjen e tij për kontributin e vazhdueshëm të komunitetit turk në të gjitha fazat e shtetndërtimit, forcimit të institucioneve, bashkëjetesës dhe besimit në shtetin e Kosovës. "Integrimi i tyre është shembulli më i mirë se Republika e Kosovës është atdhe i të gjithë qytetarëve të saj. Përmes komunitetit turk në Kosovë ne do të vazhdojmë t'i kultivojmë edhe më tej marrëdhëniet strategjike me Turqinë", ka thënë Thaçi.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se komuniteti turk gjithmonë ka luajtur rol konstruktiv. Sipas Haradinajt, komuniteti turk ishte në krah të përpjekjeve tona të përbashkëta për shtetndërtimin e Kosovës si dhe është urë lidhëse shumë e

fuqishme e vendit tonë me Turqinë. "Komuniteti turk gjithmonë ka luajtur rol konstruktiv dhe ishte në krah të përpjekjeve tona të përbashkëta për shtetndërtimin e Kosovës si dhe është urë lidhëse shumë e fuqishme e vendit tonë me Turqinë. Në shënimit të Ditës së Komunitetit Turk të Kosovës, me praninë e tij na ka nderuar edhe zëvendësministri i Jashtëm i Turqisë, Faruk Kaymakci, të cilit i shpreha mirënjohjen për përkrahjen e shtetit turk për konsolidimin e Kosovës. Bashkë me urimet e mia, bashkëqytetarëve turq, si pjesë e pandashme e shoqërisë sonë, ua përcolla gatishmërinë dhe vullnetin për bashkëpunim për avancimin e vazhdueshëm të mirëqenies së tyre dhe për sendërtimin e mëtejshëm të shtetit tonë dhe të ardhmes së lirë e të sigurt të Kosovës", ka thënë Haradinaj.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Qeveria ka miratuar tri nisma për njohje të patentëshoferëve jashtë vendit

Kabineti qeveritar ka aprovuar të martën nismat për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare me Malin e Zi, Zvicrën dhe Francën për njohje reciproke të patentëshoferëve. Miratimin e Qeverisë e ka marrë edhe nisma për amendamentimin e marrëveshjes për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 PRILL - Qeveria e Kosovës të martën ka miratuar nismat për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare me Malin e Zi, Zvicrën dhe Francën për njohje reciproke të patentëshoferëve. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka mirëpritur këtë veprim. "Me tri vendime të veçanta, kabineti qeveritar ka miratuar nismat për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare me Malin e Zi, Zvicrën dhe Francën për njohje reciproke të patentëshoferëve. Në

mbledhjen e sotme të qeverisë është miratuar ndryshimi dhe plotësimi i udhëzimit administrativ për masat e veçanta për lehtësimin e regjistrimit të pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve. Po sot miratim ka marrë edhe nisma për amendamentimin e marrëveshjes për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë", ka thënë Haradinaj pas mbledhjes së Qeverisë.

Në këtë mbledhje Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka

treguar se inaugurimi i autostradës Prishtinë - Shkup pritet të bëhet më 29 maj. Ndërsa për përmbushjen e obligimeve të pagesave nga ministria, është bërë me dije se është duke u përgatitur një raport i cili do të prezantohet para kabinetit qeveritar shumë shpejt. Po ashtu, kabineti qeveritar ka miratuar udhëzimin administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ për masat e veçanta për

regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve.

Plotësimndryshimet e udhëzimit rregullojnë mundësinë stimuluese të regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve për ta siguruar pjesëmarrjen e barabartë të gruas dhe burrit në të drejtën e pronës së paluajtshme të përbashkët.

Me propozimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit

është bërë emërimi i zëvendës-drejtorit të shërbimeve operative në Agjencinë e Navigimit Ajror të Kosovës, Valimir Hylenaj, për një mandat pesëvjeçar. Kurse Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka njoftuar kabinetin qeveritar me gjendjen e vështirë financiare të Ndërmarrjes së Ujësllësit në Mitrovicë, e cila po shkaktohet kryesisht nga mosrealizimi i inkasimit të të hyrave nga Mitrovica e Veriut.

Lirohen të kthyerit nga Siria në Kosovë, 32 gra nën hetime



PRISHTINË, 23 PRILL - Të gjithë të kthyerit nga Siria në Kosovë janë liruar nga Qendra për të Huaj në fshatin Vranidoll të Prishtinës, ku mbaheshin që nga dita e shtunë, ka konfirmuar Prokuroria Speciale e Kosovës. Ndërkaq, 32 gra të kthyerat janë duke u hetuar nga institucionet e Kosovës. Disa nga gratë e kthyerat nga Siria janë paraqitur para Gjykatës Themelore të Prishtinës. Bashkë me gratë e kthyerat kanë qenë edhe

avokatët e tyre mbrojtës.

Avokatja Blerta Shyqeriu, e cila mbron një nga gratë e që po hetohen nga prokuroria, tha se në gjykatë janë paraqitur 11 gra të cilat janë nën hetime. "Konkretisht në këtë seancë do të vendoset nëse do të vendoset një masë e paraburgimit apo mbrojtje në liri", ka thënë avokatja Shyqeriu.

Prokuroria Speciale ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se këto gra kanë qenë edhe

më parë nën hetime, porse ato janë pezulluar për shkak se të dyshuarat kanë qenë të paarrishme për prokurorinë. Sullë Hoxha nga Prokuroria Speciale e Kosovës konfirmoi rinisjen e hetimeve. "Hetimet do të vazhdojnë sepse ato edhe më parë kanë qenë nën hetime, por hetimet janë pezulluar për shkak se kanë qenë të paarrishme për prokurorinë, kështu që do të rifillojnë hetimet për 32 prej tyre", ka thënë Hoxha. Sipas

tij, edhe pse gratë janë liruar prokuroria do të vazhdojë ndërmarrjen e hetimeve.

Institucionet e Kosovës kthyen në Kosovë, mesnatën e së premtes, 110 kosovarë të cilët ishin në zonat e konfliktit në Siri.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në mbledhjen e qeverisë ka folur për procesin e kthimit të 110 kosovarëve nga zonat e konfliktit në Siri. Haradinaj ka kërkuar kujdes

ndaj të kthyerve. "Procesi i kthimit është bërë me mbështetjen e ShBA-së dhe procesi i vendimmarrjes paraprake lidhur me këtë vendim për kthim ka qenë një proces ligjor, kushtetues dhe i gjithi ka kaluar nëpër procedurat e parapara në situata të tilla. Kërkoj që ta vazhdojnë me seriozitet përkujdesen ndaj të kthyerve. Kemi propozim për dekorim të dy institucioneve tona, njërit të AKI-së dhe tjetrit të policisë", ka thënë Haradinaj.



Ulqini prezanton ofertën turistike për pushuesit nga Kosova

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 PRILL - Përfaqësues të Komunës së Ulqinit kanë prezantuar të martën para kompanive turistike të Kosovës në Prishtinë ofertën turistike të këtij qyteti bregdetar për pushuesit kosovarë.

Kryetari i Komunës së Ulqinit, Loro Nrekiq, ka thënë se me qëllim që qyteti t'i kthehet traditës së vjetër janë duke bërë disa investime infrastrukturore që do ta shpejtojnë ardhjen e pushuesve kosovarë në Ulqin. Ai ka deklaruar se qëllimi është që të rritet interesimi për sezonin turistik edhe në aspektin ekonomik, turistik dhe kulturor pasi, siç u shpreh Nrekiq, interesimi për investime nga shqiptarët është rritur dukshëm. Duke premtuar furnizim me ujë dhe energji elektrike 24 orë, i pari i Ulqinit ka theksuar se janë duke punuar për ofrim

më të madh për parkingje.

Ai u shpreh se janë duke punuar në pjesët e lashta të Ulqinit në mënyrë që të investohet edhe më shumë në hapësira atraktive për vizitorët. "Familjarisht njihemi me Kosovën dhe komuna jonë është zhvilluar më shumë sesa në periudhën e kaluar. Duhet ta kthejmë bukurinë e Ulqinit që e kishte në vitet '70. Kemi marrë disa hapa për infrastrukturë me 5 milionë euro, edhe një tjetër për 20 milionë euro. Ne do të punojmë që kjo komunë të marrë investime nga Kosova ku ka shumë të interesuar për të investuar në hoteleri. Qëllimi ynë është që Ulqini të jetë një ndër komunat më të zhvilluara të Malit të Zi. Ulqini është qytet 2500-vjeçar dhe kemi marrë masa që Ulqini të ketë ujë, rrymë elektrike dhe pastërti, ndërsa një risi është se do të ketë edhe parking", ka thënë ai.

Kurse zëvendësministri i

Turizmit në Mal të Zi, Qazim Hoxhiq, u shpreh se për 20 për qind është rritur numri i vizitorëve në Mal të Zi krahasuar me vitin 2017. Ai ka thënë se për këtë sezon janë përgatitur 348 plazhe për të pushuar në Ulqin dhe çmimet do të jenë të njëjta si në vitin e kaluar. Hoxhiq ka thënë se numri i turistëve ka qenë 2 milionë, ndërsa të ardhurat ishin 10 miliardë euro.

Drejtori i Organizatës Turistike të Ulqinit, Fatmir Gjeka, ka thënë se çdo vit vijnë në Kosovë për ta prezantuar ofertën e tyre. "Secilën herë vijmë me oferta të reja. Kemi festivale të ndryshme, kurse çmimet janë në nivel më të ulët në rajon", ka thënë ai.

Ndërkaq, ambasadori i Malit të Zi në Kosovë, Ferhat Dinosh, ka thënë se marrëdhëniet e shqiptarëve me malazezët janë shumë të mira. "Dua të përmend disa elemente që janë ngulitur. Ulqini do të jetë shtëpi

Kurtishaj bën thirrje që të ketë unifikim për turizëm në të gjitha trevat shqiptare

Kryetari i Shoqatës së Transportit Rrugor të Kosovës, Ruzhdi Kurtishaj, ka apeluar që të bëhet një unifikim dhe të zhvillohet turizmi në trevat shqiptare. Ai ka thënë se "Sharr Travell" është kompania e vetme që promovon turizmin shqiptar vetëm në trevat shqiptare. Kurtishaj ka thënë se sezoni turistik për kompaninë e tij fillon në datën më historike të shtetit të Kosovës, më 17 shkurt, dhe përfundon në datën më të rëndësishme të popullit shqiptar, më 28 nëntor.

Kurtishaj ka dhënë vërejtje edhe sa iu përket çmimeve për tarifa kufitare të sigurimeve, procedurave burokratike në kufi, si dhe çmimit që duhet paguar në stacion të autobusëve në Ulqin. Gjithashtu, ai ka dhënë edhe vërejtje për çmimet e larta që paguhet në plazhe. Kurtishaj ka theksuar se e mira e sezonit turistik në Ulqin është nënshkrimi i marrëveshjes së protokollit teknik për mosndëshkueshmëri gjatë sezonit turistik, për të cilën gjë ka apeluar që të vazhdojnë edhe në këtë sezone turistike.

verore për shqiptarët e Kosovës dhe Prishtina do të jetë shtëpia e studentëve tanë ku kanë privilegje. Kosova ka marrëdhënie të mira me ne edhe në vitin '99 i

kemi pasur 100 mijë kosovarë atje dhe besoj se bashkëpunimi ynë do të vazhdojë edhe në fushën ekonomike", ka thënë Dinosh.



Ligji që përgjysmon Qeverinë

PRISHTINË, 23 PRILL - Qeveria e Kosovës është një prej qeverive më të mëdha në Evropë pasi përbëhet nga gjithsejtë 21 ministër, 5 zëvendëskryeministër si dhe rreth 80 zëvendësministër. Por numri i ministrave dhe zëvendësve të tyre pritet të ulet, në rast se Qeveria e tanishme arrin të përfundojë Ligjin për Qeverinë i cili është në fazën e parë të hartimit. Organizatat e shoqërisë civile që janë të përfshira në procesin e hartimit të këtij ligji kanë rekomanduar që Qeveria të ketë më së shumti 14 ministër.

Poashtu, ligji parasheh që të rregullojë edhe përfaqësimin e grave në Qeveri, ku 30 për qind e ministrave do të udhëhiqen nga gratë.

Albana Rexha nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, thotë se Ligji për Qeverinë duhet të specifikojë numrin e ministrave, zëvendëskryeministrave dhe këshilltarëve politikë

në Qeveri. "Kryeministrin e kemi paraparë që t'i ketë vetëm dy zëvendëskryeministër, ndërkaq ministrat të kenë vetëm nga një zëvendësministër, në raste të caktuara siç është rasti i Ministrisë së Punëve të Jashtme mund të ketë edhe dy zëvendësministër për shkak të kontekstit dhe nevojës për të qenë sa më prezentë në arenën ndërkombëtare", ka thënë Rexha.

Përveç numrit të madh të zëvendësministrave, Qeveria aktuale ka po ashtu numër të lartë të këshilltarëve politikë. Vetëm kryeministri, Ramush Haradinaj, ka 15 këshilltarë politikë që paguhen nga paratë e taksapaguesve kosovarë.

Në Grupin për Studime Juridike dhe Politike thonë se është propozuar që me këtë ligj të saktësohet edhe numri i këshilltarëve në Qeveri, pra, sipas propozimeve, kryeministri do t'i ketë maksimum 10 këshilltarë

të brendshëm të cilët paguhen nga buxheti i shtetit.

Mungesa e Ligjit për Qeverinë, sipas Jeton Mehmetit nga Instituti GAP, ka dërguar në një situatë kur për qeverinë e tanishme, është e vështirë llogaridhënia. "Ligji për Qeverinë do të duhej të reduktonte numrin e ministrave dhe ne kemi bërë edhe studime të mëhershme ku kemi analizuar se cilat nga ministritë do të mund të bashkoheshin në një meqë nga qëllimi dhe funksioni kanë të njëjtën gjë. Qëllimi i dytë që do të duhej të kishte Ligji për Qeverinë është që të kufizonte edhe numrin e dikasterit qeveritar që nënkupton që edhe kryeministri të mos kishte më shumë se një zëvendës përderisa ministrat të mos kishin më shumë se një, eventualisht dy zëvendës, sepse kësajsoj vetëm që do të reduktoheshin shpenzimet buxhetore por edhe llogaridhënia do të ishte më e lehtë. E

treta do të ishte që ligji të rregullojë kompetencat e Qeverisë në largim", ka thënë Mehmeti.

Kryesuesi i Komisionit për hartimin e Projektligjit për Qeverinë, Besnik Tahiri, që njëherësh është edhe Koordinator Nacional për Reforma Shtetërore, kohë më parë ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se Ligji për Qeverinë, rregullon funksionimin dhe përgjegjësitë e ministrave si dhe trajton aspektin që lidhet me numrin e resorëve. "Ky ligj nuk do të ketë kuptim nëse nuk sanksionohet, nuk vendoset një tavan për numrin e ministrave, që nënkupton që ky ligj, detyrimisht do të bëjë zvogëlimin e ministrave, sikurse që do të bëjë zvogëlimin e zëvendëskryeministrave dhe zëvendësministrave", ka thënë Tahiri.

Para se ky ligj të hyjë në fuqi, ai do të kalojë nëpër një fazë të gjatë derisa të jetë në votim para

deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Në rast se pranohet propozimi i shoqërisë civile, atëherë ministri do të të humbin pozitën e tyre nëse nuk janë llogaridhënës para deputetëve të Kuvendit, thotë Albana Rexha nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike. "Ne kemi sugjeruar që nëse një ministër nuk merr pjesë në komisione për raportim apo seanca parlamentare më shumë se gjashtë herë, atëherë duhet të largohet nga detyra e tij apo e saj zyrtare", ka deklaruar Rexha.

Qeveria e drejtuar nga kryeministri Ramush Haradinaj është kritikuar vazhdimisht për vendimin për rritjen e pagave për zyrtarët e lartë si dhe për numrin e madh të zëvendësministrave dhe koston që ata kanë për buxhetin e Kosovës, mirëpo, përkundër kësaj qeveria vazhdon të ketë rreth 80 zëvendësministër.



Posta nxjerr pulla postare me veprat e artistit Esat Valla

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Në kuadër të tematikës "Arti vizual: Esat Valla - veprat", Filatelia e Postës së Kosovës emetoi pullat postare me imazhet artistike të piktorit të shquar kosovar Esat Valla.

Esat Valla lindi në Gjakovë më 22 prill 1944. Artin vizual kosovar e begatoi me vepra që japin kuptimin dhe narracionin e veçantë të një surrealisti që, pa dyshim, kanë vlerë të pamohueshme jo vetëm artistike, por edhe his-

torike. Periudhat e krijimtarisë së artistit janë po ato të popullit dhe atdheut të tij. Megjithatë, siç shprehet vetë piktori: "Në art është e pranishme fshehtësia. Duhet të kemi respekt për atë fshehtësi. Kur njeriu mendon se e ka zbuluar, ajo është zgjuar edhe është thelluar diku pas". "Tri pulla postare që emetohen në kuadër të këtij emisioni prezantojnë dy periudha të krijimtarisë së Vallës. 'Hasjanja pranë dritares' dhe 'Hasjanja pas par-

makëve', të realizuara në vitet e mëhershme, paraqesin shqetësimin e piktorit për ta paraqitur të kaluarën e veshjeve autoktone të vajzave të Hasit. 'Dritarja, roleta e këputur' paraqet shqetësimet e viteve '81-'91", thuhet në njoftimin e Postës së Kosovës.

Veprat e piktorit Esat Valla janë mjaft të pasura me simbolikë mistike, dyer të vjetruara ndër shekuj, dollapë, dritare, imazhe të zakonta me konkretësinë e

tyre tërheqëse. Veprat e tij kanë si pikë referimi përvojën e vet artistit, atë profesionale dhe atë jetësore, duke denoncuar pashtershmërinë e imazheve, ndjeshmërinë dhe risinë e tyre, raportin midis së shkuarës dhe të tashmes, referimet simbolike, të cilat, në kontekstin e tyre më të plotë, përmbajnë shenjë që mbart ky artist. "Filatelia e Postës së Kosovës do të angazhohet që përmes imazheve të pullave postare t'i afirmojë



vlerat tona artistike dhe kombëtare", është theksuar në këtë njoftim.

Edhe në Drenas mbillen fidanë dhe lule

DRENAS, 23 PRILL (ER) - Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Tokës, Komuna e Drenasit ka zhvilluar aktivitete të ndryshme

për pastrimin e ambientit në qendër të qytetit dhe ka vazhduar edhe me zona të tjera ku janë pastruar edhe deponi ilegale. Në

Sheshin "Fehmi Lladrovci", kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka ftuar qytetarët që të jenë të kujdesshëm për ruajt-

jenë e ambientit dhe së bashku edhe me grupet vullnetare ka mbjellë disa fidanë dhe lule në shesh dhe në zona të tjera të qytetit.



Sokol Bashota zyrtarizon kandidaturën për kryetar të Degës së PDK-së në Klinë

KLINË, 23 PRILL (ER) - Sokol Bashota ka zyrtarizuar kandidaturën për kryetar të Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Klinë. Një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ai ka shkruar se këtë vendim për kandidim për

kryetar të degës e ka marrë si rezultat i kërkesës së vazhdueshme të shumë anëtarëve dhe simpatizantëve dhe qytetarëve të Klinës.

Bashota ka theksuar se është i vetëdijshëm për të gjitha sfidat në këtë proces që e presin. "I vetëdi-

jshëm për të gjitha sfidat në këtë proces që na presin, në këtë rrugëtim llogarita në mbështetjen tuaj të pakursyer dhënë në çdo kohë. Klina meriton më shumë punë dhe punë më të mira. Dhe ne bashkërisht mund t'ia dalim", ka thënë Bashota.

Reagimi i shpejtë i policisë ua pamundëson kryerësve të vjedhin një traktor

PEJË, 23 PRILL (ER) - Policia e Kosovës, konkretisht Stacioni Policor në Klinë, më 22 prill ka pranuar informatë se persona të dyshuar janë duke e tërhequr me veturë një traktor nëpër një fushë në fshatin Gjurgjevik i Vogël i Komunës së Klinës.

Njësitë policore menjëherë i

janë përgjigjur vendit të ngjarjes dhe pas një kohe shumë të shkurtër kanë arritur ta gjejnë traktorin e tipit 'DAF', kurse personat e dyshuar kishin ikur nga vendi i ngjarjes. Lidhur me këtë rast janë angazhuar njësitet përkatëse të Policisë për t'i marrë masat e nevojshme adekuate dhe për këtë

është informuar Prokurori i Shtetit, ndërsa traktori i është kthyer pronarit të nacionalitetit serb.

Hetuesit e Stacionit Policor në Klinë janë duke punuar intensivisht për të arritur që ta identifikojnë dhe të arrestojnë kryerësin apo kryerësit e veprës së cekur më lart.



Haskuka vlerëson lart integrimin e komunitetit turk në jetën institucionale dhe shoqërore

PRIZREN, 23 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka uruar komunitetin turk që jeton në Kosovë me rastin e ditës së tyre. Me këtë rast, Haskuka ka thënë se Komuna e Prizrenit e çmon lart integrimin e komuniteteve në jetë institucionale dhe shoqërore. "Sot është 23 prilli, Dita e Komunitetit Turk në Kosovë. Uroj gjithë komunitetin turk për këtë festë, të cilën e

shënojnë edhe si Ditë të Fëmijëve. Ne si qeverisje lokale çmojmë integrimin e komuniteteve në institucione dhe shoqëri dhe do të vazhdojmë që të jemi të përkushtuar edhe më tej për një bashkëjetesë ashtu siç i ka hije Prizrenit", ka theksuar Haskuka. Komuna e Prizrenit ka numrin më të madh të komunitetit turk që jeton dhe vepron në këtë komunë.

Diskutohet për ndryshimin e rregullores për dhënien e dekoratave nga Komuna e Ferizajt

FERIZAJ, 23 PRILL (ER) - Kryesuesja e Kuvendit Komunal e Ferizajt, Kristina Gashi - Bytyçi, ka mbajtur mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, në të cilën është diskutuar për raportin vjetor të vitit 2018 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), edhe për propozimvendimin për miratimin e këtij plani. Po në këtë mbledhje është diskutuar edhe propozimvendimi për plotësimin e ndryshimin e Rregullores për Dhënien e Dekoratave 01 Nr. 27 të datës 31. 3. 2015. "Është diskutuar edhe për propozimvendimin për miratimin e draftrregullores për përcaktimin

e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive të tjera në territorin e Komunës së Ferizajt. Në këtë mbledhje u diskutua edhe raporti financiar për periudhën janar - mars 2019, por u vendos që gjerë e gjerë të diskutohet në mbledhjen e kuvendit të komunës. U diskutua edhe propozimvendimi për anulimin e vendimit të KK-së 01 Nr. 22 të datës 28.02.2019, si dhe për raportin e punës për vitin 2018", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Sipas këtij njoftimi, mbledhja e Kuvendit Komunal e Ferizajt do të mbahet më 30 prill, me fillim nga ora 10:00.



A po shndërrohet ndërtimtaria në rrezikuesin më të madh të jetës së punëtorëve?!



NGA: KESHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

Më 23 prill 2019 një i ri humbi jetën në Mitrovicë pasi u shemb një pjesë e hotelit "Adriatik" e që ishte duke u rinovuar. Po të njëjtën ditë u shemb në Fushë-Kosovë një objekt banimi që ishte duke u ndërtuar dhe, për fat të mirë, nuk kishte të lënduar e as jetë të humbura. Realisht, sot në Kosovë nuk paraqet lajm nëse ndonjë punëtor lëndohet, bëhet i paafte përjetësisht për punë apo edhe e humb jetën për faktin se punëdhënësi nuk siguron kushte për punë për të punësuarit, nuk kanë kontrata pune, nuk kanë sigurime shëndetësore e mos të flasim për sigurime të jetës. Në 99 për qind të tasteve e pësojnë punëtorët, në 1 për qind të rasteve dënohen simbolikisht punëdhënësit për ta vazhduar "vallen e vdekjes" të atyre që, për shkak të kushteve të rënda

ekonomike, detyrohen të punojnë në kushte skajshmërisht të rrezikshme për jetën, pa pasur fare siguri dhe pa u kompensuar familjet për humbje të jetës. Kosova në përgjithësi, kurse Prishtina në veçanti janë shndërruar në kantiere ndërtimi ku punohet pa orar, në ditë feste, ditë pushimi, në kushte të rënda atmosferike dhe, madje, punohet edhe gjatë natës pa pasur aspak konsideratë për sigurinë dhe qetësinë e qytetarëve. Trafiku është shndërruar në kaos ku kamionët e shumtë me dhe materiale inerte, cisternat me betone dhe mekanizmi ndërtues i rëndë, qarkullojnë nëpër rrugët e kryeqytetit pa një orar të caktuar dhe pa kufizime drejtimesh kah mund të lëvizin. Jo rrallë kemi raste kur nga kamionët derdhet dhe apo materiali inert apo kur nga gypi i betonjerkës rrjedhë betoni që, përveç se e ndotin rrugën, në shumë raste edhe e dëmtojnë! KMDLNj, për këtë arsye është takuar me Inspektoratin e Punës të Kosovës për të gjetur një mënyrë të dilet nga kjo gjendje e cila, dita-ditës po bëhet më e vështirë dhe më e papërbalueshme. Sidomos është brengosëse humbja e jetës të punëtorëve në mesin e të cilëve

ka persona të mitur. Inspektorati i Punës së Kosovës nuk ka kapacitet t'i mbulojë të gjitha vendpunimet për shkak se numri i inspektorëve është në shpërputhje të madhe me kërkesat për inspektim. KMDLNj, gjithashtu shpreh mospajtim të madh për dënimet e shqiptuara e të cilat janë tejet simbolike e që në Inspektoratin e Punës të Kosovës thonë se po veprojnë në përputhje me Ligjin. KMDLNj ka kërkuar heqjen e licencës së punës për punëdhënësit që nuk sigurojnë kushte për punë me ç'rast rrezikohet jeta e të punësuarve. Gjithashtu, KMDLNj ka kërkuar që dënimet në të holla të jenë shumë më të larta dhe nga ato mjete të grumbulluara të krijohet një Fond për ata që e pësojnë dhe

familjet e tyre. Për një punëdhënësi që qarkullon dhjetëra milionë euro në fushën e ndërtimit, dënimi prej 5 apo 10,000 euro është dënim për kafe prandaj edhe ka përsëritje të rasteve. Është e pabesueshme që edhe pas të gjitha jetëve të humbura për shkak të kushteve të punës, askush të mos ketë përgjegjësi para ligjit. Shteti duhet të gjejë një mënyrë që familjet që e humbin anëtarin e familjes duhet të kompensohen dhe ta kenë një pension, jo më të vogël se paga e një të punësuarit në ndërtimtarin. Ose duhet të ashpësojë gjohat në rast të humbjes së jetëve apo lëndimeve, ose duhet të rrisë taksat për leje ndërtimi e që një pjesë do të derdheshin në Fondin e viktimave të ndërtimtarisë por edhe

në vendet e tjera të punës e ku përgjegjësia është e punëdhënësit. Edhe planifikuesit më amatorë e kanë të qartë se Prishtina nuk ka nevojë për aq shumë ndërtime të banesave me ç'rast po rënohen lagje të tëra, disa e japin tokën apo shtëpinë me vetdëshirë kurse disa të tjerë janë të kushtëzuar për faktin se këto ndërtime ua bëjnë jetën të pajetueshme duke ua ngushtuar hapësirën jetësore. Ka shumë dyshime se përmes këtyre ndërtimeve kaotike po bëhet pastrimi i parave dhe, deri më tani nuk është bërë asnjë hetim për këtë dhe se kush janë realisht pronarë të tokave. Prandaj, edhe po lejohen të gjitha këto raste që po përfundojnë me dhjetëra e dhjetëra punëtorë, kryesisht raste sociale, që e humbin jetën në vendin e punës.

KMDLNj vlerëson se, nëse nuk ndërmerren masat parandaluese për sigurimin e kushteve të mira për punë, humbja e jetëve do të vazhdojë kurse, të gjithë ne që e kemi një përgjegjësi, do të merremi me reagime gjyqesore dhe me pasoja, që do të jenë shumë më të rënda nëse kemi parasysh që kantieret e ndërtimit kanë metas-tazuar dhe janë shtrirë në çdo pjesë të kryeqytetit.



Komisioni i granteve aprovon financimin komunal për vitin 2020 - 2022

Granti i përgjithshëm për komuna për vitin 2020 do të jetë në shumën prej 196.28 milionë eurosh. Krahasuar me vitin 2019, në këtë vit ka rritje prej 15.6 milionë eurosh

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 PRILL - Nën udhëheqjen e ministrit të Financave, Bedri Hamza, është mbajtur të martën takimi i radhës i Komisionit të Granteve, ku është diskutuar për rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve dhe është aprovuar financimi komunal për vitin 2020 - 2022. Në këtë takim është diskutuar për kornizën afatmesme të shpenzimeve 2020-2022, niveli komunal, ku me këtë dokument përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2020 dhe orientimet për vitet 2021 - 2022, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndër-qeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetjake të komunave për vitin fiskal 2020 si dhe parashikimin afatmesëm 2021 - 2022.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2020 bazo-

hen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve 2020-2022, niveli komunal burimet e Financimit Komunal për vitin 2020 - 2022 janë granti i përgjithshëm, granti shtesë për financimin e kryeqytetit, granti specifik për arsim parauniversitar, granti specifik për shëndetësi primare, financimi për shëndetësinë sekondare, financimi për shërbimet rezidenciale, financimi për qendrën historike të Prizrenit, fshatin Zym dhe Hoçën e Madhe, financimi për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit, financimi për teatro, projeksionet e të hyrave vetjake komunale si dhe investimet sipas klauzolës për investime.

Në bazë të kësaj kornize, e cila u aprovua të martën nga anëtarët e Komisionit të Granteve, granti i përgjithshëm për komuna për vitin 2020 do të jetë në shumën



prej 196.28 milionë eurosh. Krahasuar me vitin 2019, ka një rritje prej 15.6 milionë eurosh. Në kuadër të grantit shtesë për financimin e kryeqytetit, për vitin 2020 Prishtina përfiton grant shtesë prej 11,777,096 eurosh krahasuar me vitin 2019 dhe ka një rritje prej 0.9 milion eurosh. Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2020 është në shumën prej 61.7 milionë eurosh, nga të cilat 53.4 milionë euro janë grant bazë dhe 8.3 milionë euro kosto shtesë për paga dhe mëditje. Shpërndarja e grantit specifik për shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL. Granti për shëndetësinë primare për vitin 2020, krahasuar me vitin 2019, ka rritje prej 8.3 milionë eurosh. Financimi për shende-

tësinë sekondare për vitin 2020 është në shumën prej 2,603,077 eurosh. Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit të propozuara nga MPMS-ja për vitin 2020 është në shumën prej 2,040,000 eurosh. Financimi për shërbimet rezidenciale për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 0.44 milion eurosh.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligjit Nr. 04/L-196 për Qendrën Kulturore Historike të fshatit Zym dhe Ligjit Nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, me planifikimin e buxhetit për vitin 2020 ndahen mjete financiare në shumën prej 69,048 eurosh, për dy komuna si vijon: Komuna e Prizrenit, në shumën prej 44,144

eurosh dhe Komuna e Rahovecit, në shumën prej 24,904 euro.

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-044 për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, në nenin 9, Obiliqi përfiton nga inkasimi i rentës minerale nga institucioni përkatës, 20 për qind e vlerës së kësaj rente rialokohet nga Buxheti Qendror për Buxhetin Komunal të Komunës së Obiliqit, e dedikuar në mënyrë specifike për investime në zhvillimin e komunitetit në lokacionin ku ndodhet njësia biznesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, sportit, shëndetësisë dhe arsimit. Për vitin 2020 Komuna e Obiliqit, bazuar në inkasimin e rentës minerale, përfiton financim shtesë prej 4,175,567 eurosh.

E rrallë

Gruaja papritur zgjohet nga koma pas 28 vjetësh

Një grua në Lindjen e Mesme është zgjuar papritur pasi qëndroi në koma për 28 vjet. Munira Abdulla pësoi dëmtim të rëndë të trurit në një aksident automobilistik në vitin 1991. Makina me të cilën ajo po udhëtonte drejt shtëpisë u përplas nga një autobus. Në atë kohë ajo ishte 32 vjeçe dhe me kalimin e viteve



nuk kishte shenja se mund të shërohej, por tani është kthyer në vetëdije dhe gjendja e saj vazhdon të përmirësohet.

FOTO E DITES



Një djalë budist e ka kapur gjumi në Tempullin e Jogyes në Seul të Koresë së Jugut. /AP/

E jashtëzakonshme

Gjen një biletë 'Gërvisht dhe fito' fituese në plehra

Kush banon në zonë, e njih si të apasionuar të lojës 'Gërvisht dhe fito'. Kush e di sa kishte blerë deri tani dhe kurrë nuk kishte fituar. Por, kësaj radhe, një peshkatar 50-vjeçar nga Mola e Barit në Itali pati shumë fat. Duke kontrolluar mes mbeturinave në kërkim të biletave të



hedhura nga lojtarët e tjerë, gjë që ishte mësuar ta bënte, burri gjeti një biletë fituese, duke fituar kështu 100 mijë euro.

BARSOLETA E DITËS



Kryeministri e viziton një çerdhe. I sheh fëmijët duke luajtur dhe i thotë ministrit të Financave:
- Ndajini 5 000 euro për përmirësimin e kushteve të çerdhes.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 20:00

"CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.
Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

"U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon
Regjia: Academy Award-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Sot jeni nostalgjik dhe po mendoni veç për dashurinë. Një ndjenjë e mirë që ju bën mjaft të përkushtuar ndaj njerëzve.</p>	 <p>DEMI Megjithëse në fundjavë keni pasur mjaft surpriza, ende nuk ka përfunduar efekti i tyre. Do të vazhdoni të merreni me to edhe sot.</p>	 <p>BINJAKËT Gjithkush që mbush ditën tuaj sot do të merret me punët e veta personale duke ju lënë të qetë të mbyllni gjëra që ju ka kaluar afati.</p>	 <p>GAFORRJA Jeni i gatshëm ta jepni kontributin tuaj për të ndryshuar disa mendësi në familjen tuaj që janë disi të prapambetura. Do të kërkon mbështetje.</p>	 <p>LUANI Jeni goxha të ngarkuar në punë sot dhe nuk do të mund të bëni dot asgjë pa miratimin e një kolegut tuaj. Në debat e sipër do t'i tejkaloni pak limitet.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Dita sot do të fillojë shumë vrullshëm dhe ju nuk do të keni kohë të merrni frymë nga impenjimet e shumta.</p>
 <p>PESHORJA Me miqtë dhe të afërmit koha kalon shkëlqyeshëm, por sapo afrohet dikush i panjohur në orbitën tuaj bëheni mjaft protektive.</p>	 <p>AKREPI Po mbani ekuilibër të brendshëm me ata persona që e shikoni që kanë gjithmonë diçka për të thënë kundër jush. Nuk do të arrijnë t'ju prishin ditën.</p>	 <p>SHIGJETARI Financat tuaja paraqiten shumë mirë këtë periudhë dhe gjithçka ka të bëjë me kontrata dhe marrëveshja do të jetë në favorin tuaj.</p>	 <p>BRICJAPI Hëna në shenjë ju ndihmon sot të mos afektoheni shumë nga nostalgjia dhe nga probleme të vogla që mund t'ju prishin punë.</p>	 <p>UJORI Sot jeni të pushtuar nga dashuria dhe këtë herë e keni lëshuar totalisht veten ta përjetoni pasionin dhe dëshirën me sy mbyllur.</p>	 <p>PESHQIT Një shef skrupoloz ose një i afërm i bezdisshëm sot s'po ju lënë të qetë. Në çdo moment do të jepni informacione se çfarë jeni duke bërë.</p>

Jennifer Lopezi dhe Owen Wilson sërish bashkë në një film të ri



Jennifer Lopezi dhe Owen Wilson janë bashkuar sërish për një film të ri. 49-vjeçarja dhe 50-vjeçari kanë nënshkruar kontratë për një komedi të ardhshme romantike që titullohet "Marry

Me". Filmi bazohet në një roman nga Bobby Crosby. Kjo nuk është hera e parë që këta dy artistë luajnë në një film. Jenniferi dhe Oweni u shfaqën në filmin e vitit 1997 "Anaconda".



Nëna e Meghan Markles arrin në Britani të Madhe

Doria Ragland është gati ta takojë nipin ose mbesën e saj. Nëna e Meghan Markle ka mbërritur në Britani të Madhe, raporton "Entertainment Tonight", pasi dukësja e

Sussexit është në pritje të fëmijës së saj të parë me Princin Harry. "Është një kohë kaq e lumtur dhe emocionuese për Meghan. Ajo duket shumë e lumtur", ka thënë një burim.

Wiz Khalifa nis turneun këtë verë



Wiz Khalifa do të shkojë në turne këtë verë. Lajmin e ka bërë me dije reperi 31-vjeçar gjatë festivalit të muzikës Coachella 2019. Turneu në 29 qytete

do të fillojë më 9 korrik në Atlanta, Gjeorgji, para se të përfundojë më 15 gusht në Biose, Idaho. Biletat do të dalin në shitje nga sot (e mërkurë).

Fansat e gjuajnë me limon Ariana Granden



Ariana Grande u përball me një incident aspak të këndshëm gjatë performancës së saj në "Coachella 2019" të hënën, pasi një person nga publiku e goditi me limon. "Ja ç'ndodh ngaqë

dikush nga ju më goditi me limon, dreq", u shpreh këngëtarja dhe u largua nga skena. Por, pak minuta më pas Ariana u rikthye sërish në skenë duke kënduar hitin e saj të fundit të titulluar "NASA".

Borges: Libri përherë

Ndër instrumentet e shumtë të njeriut, më i mahnitshmi, pa dyshim, është libri. Instrumentet e tjera janë zgjatim i trupit të tij. Mikroskopi dhe teleskopi janë zgjatim i pamjes; telefoni është zgjatim i zërit; kemi edhe parmendën dhe shpatën, kuptohet zgjatime të krahut. Por libri është diçka tjetër: libri është zgjatim i kujtesës dhe imagjinatës

Në librin "Qezari dhe Kleopatra", Bernard Shaw thotë për bibliotekën e Aleksandrisë se ajo është kujtesa e njerëzimit. Por libri ka diçka më tepër. Ai është edhe imagjinata e tij. Sepse a nuk është e kaluara jonë një seri ëndrrash? Ç'ndryshim mund të ketë midis kujtoj ëndrrat dhe kujtoj të kaluarën. I tillë është funksioni që kryen libri. Njëherë kam menduar të shkruaja një histori të librit. Jo për pamjen e tij fizike. Nuk më intereson aspekti fizik i librave (sidomos i bibliofilëve që e teprojnë), por më interesojnë vlerësimet që janë dhënë për librin. Përpara meje e ka bërë Spengler-i tek vepra "Perëndimi i Oksidentit" ku ka ca faqe të mrekullueshme për librin. Duke u shtuar atyre ndonjë vëzhgim timin, unë kam ndërmend të mbetem në ato që thotë Spengler-i.

Në lashtësi nuk e kishin kultin e librit si e kemi ne - dhe kjo nuk më befason; ata shihnin te libri një surrogato të fjalës së folur. Shprehja që përdoret shpesh. Scripta manent verba volant, nuk ka kuptimin që fjala është jetëshkurtër, porse që shkrimi ka diçka të ngurosur si vdekja. Në të kundërt, fjala ka diçka të lehtë, flatrore; diçka flatrore e të shenjtë, siç thotë Platoni. Është e çuditshme, por gjithë mësuesit e mëdhenj të njerëzimit kanë dhënë mësimet gojore.

Le të marrim rastin e parë: Pitagorën. Ne e dimë se ai e zgjodhi me vetëdije që të mos shkruante. Dhe këtë e bëri se nuk donte të ishte i lidhur pas fjalës së shkruar. Me sa duket ai e ndjente shprehjen që më pas do të thuhet edhe në Bibël: shkronja vret, shpirti ngjall. Prandaj Aristoteli nuk flet kurrë për Pitagorën, por për pitagorianët. Për shembull, ai thotë se pitagorianët jepnin mësim besimin, dogmën e kthimit të përjetshëm që Niçe do ta zbulonte shumë më vonë. Domethënë idenë e një kohe ciklike, e cila u hodh poshtë nga Shën Agostini te libri "Qyteti i Zotit". Shën Agostini duke përdorur një metaforë të shkëlqyer thotë se Kryqi i Krishtit na shpëton nga labirinti qerthullor i stoikëve.

Ideja e kohës ciklike ka qenë prekur edhe nga Hume-i, nga Blanqui e nga shumë të tjerë. Pitagora nuk shkroi në mënyrë të vullnetshme. Ai donte që mendimi i tij të jetonte përtej vdekjes së tij trupore, të mbijetonte në mendjen e nxënësve të tij. Nga kjo ka lindur formula që unë duke mos ditur greqisht do ta them latinisht: magister dixit. (e ka thënë mjeshtri). Kjo nuk do të thotë se ata qenë të kushtëzuar pas asaj që kishte thënë mjeshtri, përkundrazi me këtë ata vërtetonin se ishin të lirë të zhvillonin mendimin fillestar të mjeshtrit.

Ne nuk e dimë nëse doktrinën e kohës ciklike e ka shpikur Pitagora, por dimë se nxënësit e tij ua mësonin të tjerëve. Pitagora vdiq trupërisht dhe ata me një lloj transmigrimi që atij do t'i kishte pëlqyer, vazhduan t'i mendonin e t'i thellonin idetë e tij, aq sa kur i qortonin se duhej të thoshin gjëra të reja, mbroheshin me formulën: E ka thënë mjeshtri (Magister dixit). Mund të kujtojmë raste të tjera. Kemi shembullin e madh të Platonit kur thotë se librat janë si efizhitë (ai kishte parasysh mbase statuja apo tablo), që njeriu i pandeh të gjalla, por kur i pyet, ato, s'të përgjigjen. Dhe për ta korrigjuar këtë heshtje të librave, ai shpiku dialogun. Pra, Platoni vetë shndërrohet në personazhe të ndryshme: në Sokrat, në Gjorgjia e të tjerë. Mund të na shkojë në mendje edhe se Platoni donte të ngushëllohej për vdekjen e Sokratit, duke e përfytyruar të gjallë. Dhe çfarëdo problemi që t'i dilte, ai pyeste veten: Çfarë do të kishte thënë Sokrati për këtë. Ai qe si të thuash pavdekësia e Sokratit, që s'pati lënë asgjë të shkruar dhe ishte gjithashtu mjeshtër i fjalës së folur.

Për Krishtin dimë se ka shkruar një herë të vetme ca fjalë mbi rërë e që u fshinë. Nuk dimë të ketë shkruar gjë tjetër. Edhe Buda ishte mjeshtër i të folurit; na ka lënë disa predikime. Pastaj, kemi edhe një frazë të Shën Anselmit, i cili thotë: "Të vësh një libër në duart e një injoranti, është po aq e rrezik-

shme sa të vësh një shpatë në duart e një fëmije". Ja pra se çfarë mendohej atëherë për librin.

Në të gjithë Orientin ende gjallon ideja se qëllimi i një libri nuk është t'i zbulojë gjërat: një libër duhet thjesht të na ndihmojë për t'i zbuluar. Me gjithë paditurinë time në hebraisht, e kam studjuar pak Kabalën dhe kam lexuar versione anglisht e gjermanisht të Zoharit (Libri i Shkëlqimit) dhe të Sefer Jezirasë (Libri i Marrëveshjes). Unë e di se këta libra nuk janë shkruar për t'u kuptuar, por për t'u interpretuar, ata duhet ta nxisin lexuesin që të zhvillojë një ide. Antikiteti klasik nuk e kishte respektin që kemi ne për librin edhe pse kemi mësuar se Aleksandri i Madh mbante nën jastëk "Iliadën" dhe shpatën, dy armët e tij. Ushqehet respekt për Homerin, megjithatë ai nuk shihej si shkrimtar i shenjtë, në kuptimin që ka sot kjo fjalë. Nuk mendohej se "Iliada" dhe "Odiseja" ishin tekste të shenjta; ato qenë tekste që vlerësoheshin, por edhe mund t'i kritikojë.

Platoni i flaku poetët nga "Republika" e tij; gjithsesi pa u bërë i dyshimtë për herezi. Këtyre dëshmime të antikitetit kundër librit, ne mund t'u shtojmë një tjetër, shumë interesante të Senekës. Mes letrave të tij të pakrahasueshme drejtuar Lucillit, njëra i drejtohet një personi mendjemadh, për të cilin tregon se kishte një bibliotekë me njëqind vëllime; dhe kush - thotë Seneka - mund ta gjejë kohën për të lexuar njëqind vëllime. Ndërsa sot, përkundrazi, çmohen bibliotekat e mëdha.

Pra, në antikitet për librin ka një qëndrim që mezi e kuptojmë, që nuk ngjason me kultin që kemi ne për librin. Te ky i fundit shihej përherë një surrogato e fjalës. Por më pas nga Orienti vjen një koncept krejt i panjohur për antikitetin klasik: Koncepti i librit të shenjtë. Do të marrim dy shembuj duke filluar nga më i vonshmi, nga ai i myslymanëve. Ata mendojnë se Kurani i paraprin Krijimit dhe është më i moçëm se gjuha arabe. Kurani, thonë ata, nuk është vepër e Zotit, por njëra prej vetive të tij, siç janë mëshira apo drejtësia. Aty flitet në një mënyrë të pabesueshme për mëmën e librit. Mëma e librit është një kopje e Kuranit të shkruar në qiell. Shkurt, ai është arketipi platonian i Kuranit, dhe ky libër është shkruar në qiell, thotë Kurani - si atribut i Zotit, e për më tepër është më i hershëm se Krijimi. Këtë gjë e thonë edhe ulemat apo doktorët myslymanë.

Pastaj ka shembuj të tjerë më pranë nesh, siç janë Bibla ose më konkretisht Torah apo Pentateka. Mendohet se këta libra janë diktuar nga Shpirti i shenjtë. Është interesant fakti që këta libra të autorëve dhe epokave të ndryshme, i lihen një shpirti të vetëm; a nuk thuhet madje në Bibël se shpirti frymon ku të dojë? Hebrejntë patën idenë të bashkonin vepra letrare të periudhave të ndryshme dhe të krijonin me to një libër të vetëm me titull Torah që në greqisht do të thotë Bibël. Këta libra i lihen një autori të vetëm: Shpirtit.

E pyetën një ditë shkrimtarin Bernard Shaw nëse besonte që Biblën e kishte shkruar Shpirti i shenjtë. Dhe ai u përgjigj kësh-tu: Çdo libër që ia vlen ta rilexosh, është shkruar nga Shpirti. Ta themi disi më ndryshe. Një libër duhet të shkojë përtej qëllimeve të autorit. Qëllimi i autorit është një gjë e varfër, njerëzore që mund të dështojë, kurse libri është më shumë. Don Kishoti, bie fjala, është më tepër se një satirë e romaneve kalorsiake. Në të vërtetë ai është një tekst absolut, tek i cili asgjë, absolutisht asgjë nuk i lihet rastësisë.

Të mendojmë ndërveprimet e kësaj ideje. Për shembull, nëse unë them:

*Corrientes aguas, puras,
cristalinas
arboles que os estais mirando
en ellas
verde prado, de fresca sombra
lleno.
(Ujëra të gjalla me dritë
kristalin
pemë që shfaqeni ndër
pasqyrime,
livadh i blertë plot hijeshi e
freski)*

duket qartë se këto tri vargje kanë nga njëmbëdhjetë rrokje. Kështu ka dashur autori. Është zgjedhje e tij.

Por çfarë është kjo, krahasuar me një libër të shkruar nga Shpirti, krahasuar me konceptin e Hyjnisë që zbret në letërsi dhe dikton një libër. Në një libër të këtyllë asgjë s'mund të jetë e rastësishme, asgjë, deri edhe zgjedhja e shkronjave duhet ta ketë një arsye. Me këtë logjikë e kuptojmë, përse fillimi i Biblës, Bereshit baraelohim është me B, sepse kjo i përgjigjet fjalës bekoj. Fjala është pra, për një libër, në të cilin kurrë nuk është e rastësishme, absolutisht asgjë. Mbërrimë kështu te Kabala, tek studimi i shkronjave, te një libër i shenjtë i diktuar nga Hyjnia, domethënë në të kundërt të asaj që mendonin të vjetrit. Ata mendonin për muzën në një mënyrë mjaft të vagëlluar.


Këndo, muzë, zemërimin e



Akilit, ("Këndo hyjneshë, mëninë e Akil Pelidit", është përkthim i shkëlqyer i Gjon Shllakut, por ky përkthim fjalë për fjalë, me varfëri semantike këtu bëhet, sepse ka një koment lidhur me fjalën muzë. Shën i përkth.) thotë Homeri në krye të Iliadës. Këtu muza përfaqëson frymëzimin. Po të mendojmë Shpirtin, pranojmë diçka më konkrete e më të fuqishme: Zotin që është brenda letërsisë. Zotin që shkruan libër, në të cilin gjithçka arsyetohet: numri i shkronjave, i rrokjeve, i verseteve, ku bëhet lojë fjalësh me shkronja, të cilat tashmë i kemi studjuar.

Ideja e dytë e madhe që kemi për librin, është se ai, po e përsëris, mund të jetë vepër hyjnore. Sigurisht kjo ide është më afër asaj që kemi sot për librin se ajo e lashtësisë që e vështron librin si një surrogato të fjalës së folur. Pastaj besimi në një libër të shenjtë humbet dhe zëvendësohet prej besimeve të tjera. Ekziston bindja, për shembull, se çdo vend njëjtësohet me një libër. Duhet të kujtojmë këtu se myslymanët i quajnë izraelitët njerëz të Librit, le të kujtojmë gjithashtu atë që ka thënë Henri Heine në lidhje me kombin, atdheu i të cilit ishte një libër Bibla, çifutët. Dhe lind kështu ideja e re, sipas së cilës çdo vend duhet të përfaqësohet nga një libër, apo nga një autor që mund të ketë

ruan një shenjtërim



shkruar shumë libra.

Është e çuditshme - dhe nuk besoj se ky fakt është vënë re deri tani - por vendet kanë zgjedhur individë që nuk u ngjajnë shumë. Dikush, për shembull, mendon se Anglia mund të kishte zgjedhur Samuel Johnson-in, por ajo ka zgjedhur Shekspirin dhe Shekspiri është si të thuash - më pak anglezi ndër shkrimtarët anglezë.

"Understatement-i, pra, është karakteri tipik i anglezitet. Por Shekspiri prirë ndaj hiperbolës në metaforë dhe nuk do të habiteshim fare nëse ai do të kishte qenë italian apo çifut.

Kështu ka ndodhur edhe me Gjermaninë, ky vend i bukur fanatik për hiçgjë, zgjodhi pikërisht një njeri tolerant, aspak fanatik, të cilit nuk i intereson shumë nocioni atdhe, pra zgjodhi Gëten. Gjermania përfaqësohet nga Gëte.

Në Francë nuk është zgjedhur ndonjë, por ka një dobësi për Hygoin. Natyrisht, unë ushqej një admirim të madh për Hygoin, por Hygoi nuk është francez tipik. Hygoi është i huaj për Francën: me dekoret e tij të mëdha e me metaforat e panumërta, ai s'është përfaqësues i Francës.

Edhe më i habitshëm është rasti i Spanjës. Ajo mund të përfaqësohej nga Lope De Vega, nga Calderon, nga Quevedo. E pra, jo! Nuk ndodhi ashtu! Spanja

përfaqësohet nga Migel de Servantes. Servantesi është bashkëkohës i Inkuizionit, por është një njeri tolerant që nuk zotëron as virtytet dhe as cenet e spanjollëve.

Ngjason sikur çdo vend mendon se duhet të përfaqësohet nga dikush që ndryshon prej tij, nga dikush që mund të jetë si një lloj bari shërues, një lloj opiumi, një kundërhelm ndaj të metave. Ne argentinasit, mund të kishim zgjedhur "Fakundon" e Sarmientos, që është libri ynë, por jo; me historinë tonë ushtarake, me historinë e betejave, ne kemi zgjedhur si libër kronikën e një dezertori, kemi zgjedhur librin "Martin Fierro", që padyshim meriton të zgjidhet, por si mund të mendohet që historia jonë të përfaqësohet nga një dezertor i pushtimit të tokave? Gjithsesi kështu është: çdo vend duket se provon mbëhinë e kompensimit.

Për librin janë shkruar faqe të ndritura nga shumë shkrimtarë. Do të doja të citoja ndonjërin prej tyre. Po e nis me Montenjin, i cili një nga esetë e tij ia kushton pikërisht librit. Në këtë ese ka një frazë të tillë, të paharrueshme. "Unë nuk bëj asgjë pa gëzim". Montenji lë të kuptohet se koncepti i të lexuarit me çdo kusht, është një koncept i gabuar. Ai thotë se kur has ndonjë pjesë të vështirë në një libër, ai e lë, sepse akti i të lexuarit është një formë e lum-

turisë.

Më kujtohet se para shumë vitesh u bë një anketë ku pyetej se çfarë shpreh piktura. E pyetën motrën time, Norën, dhe ajo u përgjigj se piktura ishte arti që dhuron gëzim me forma dhe ngjyra. Unë do të thosha se edhe letërsia është një formë e këtij gëzimi. Nëse diçka lexohet me vështirësi, autori nuk e ka përmbushur misionin e vet. Ja përse unë mendoj se një shkrimtar si Xhojsi në thelb e ka harruar misionin, sepse vepra e tij lyp mundim për ta lexuar.

Një libër nuk duhet të kërkojë mundim, sepse lumturia nuk duhet të kërkojë mundim. Më duket se Montenji ka të drejtë. Pas kësaj ai numëron autorët që ka për zemër. Përmend Virgjinin dhe pohon që më shumë pëlqen "Gjeorgjikat" se "Eneidën". Unë për vete pëlqej "Eneidën", por s'është këtu çështja. Montenji flet me pasion për librat dhe thotë se librat janë një kënaqësi e ngadaltë...

Ndërsa Emersoni thotë të kundërtën. Nga ai e kemi studimin tjetër të madh për librin. Në një nga ligjëratat e tij, Emersoni thotë se biblioteka është një lloj kabineti magjik. Në këtë kabinet rrinë të magjepsur shpirtat më të zgjedhur të njerëzimit, të cilët presin fjalën tonë për të dalë nga heshtja. Duhet ta hapim librin që

shpirtat të rizgjojnë. Ai thotë se ne duhet të kemi besim në shoqërinë e njerëzve më të mirë që ka prodhuar njerëzimi, por që ne nuk i kërkojmë dhe na pëlqen më tepër të lexojmë komantarë e kritika, në vend që të lexojmë autorët vetë.

Për njëzet vjet unë kam qenë profesor i letërsisë angleze në universitet, në fakultetin e filozofisë e të letërsisë në Buenos-Aires. Gjithmonë u thosha studentëve të mi që të kishim një bibliografi sa më të seleksionuar, të mos lexonin libra kritike, por drejtpërdrejt autorët; ndoshta do të kuptonin më pak, por do të kishin kënaqësinë të dëgjonin zërin e dikujt. Do të thosha se më i rëndësishëm tek një autor është tingulli i zërit (stili, shën. i përth.), pra më i rëndësishëm tek një libër është zëri i autorit, ai zë që arrin të vijë gjer te ne.

Unë një pjesë të madhe të jetës në të vërtetë ia kam kushtuar letërsisë, dhe besoj se leximi është një formë e lumturisë; një tjetër formë e lumturisë, më e pakët, është krijimi poetik, apo ajo çka quhet krijim, që është përzjerje e harresës dhe e kujtesës së asaj që kemi lexuar. Emersoni bashkohet me Montenjin kur thotë se duhet lexuar çfarë na pëlqen, sepse siç e thamë libri duhet të jetë një formë e lumturisë. Ne i detyrohemi shumë letërsisë. Unë, më tepër jam i prirur të rilexoj se sa të lexoj dhe kam mendimin, se më e vlefshme është të rilexosh sa të lexosh, duke mos lënë pa përmendur se për të rilexuar duhet të kesh lexuar. Unë e kam këtë kult për librin. Mbase e them në një mënyrë që tingëllon disi patetike, por s'do të doja të ishte kështu. Do më pëlqente të ishte si një lloj besimi që kam për secilin prej jush, jo për të gjithë, sepse të gjithë është abstraksion dhe secili është një realitet.

Duke patur kultin e librit, unë vazhdoj të bëj sikur nuk jam i verbër, vazhdoj të blej libra e të mbush shtëpinë me to. Një ditë më parë më bënë dhuratë një botim të vitit 1966 të Encyclopedie de Brockhaus. Dhe e ndjeva praninë e kësaj vepre në shtëpi, e kam ndjerë si një lloj lumturie. I kisha pranë meje të njëzet vëllimet me shkronja gotike, të cilat nuk mund t'i lexoj, plot harta dhe gravura që nuk mund t'i shoh: por sidoqoftë vepra ishte aty. Provoja një si tërheqje miqësore. Kam mendimin se libri është një nga lumturitë e mundshme të njeriut.

Sot flitet për zhdukjen e librit: mua më duket se kjo është e pamundur. Do të më thonë se cili është ndryshimi mes një

libri dhe një gazete apo një disku? Ndryshimi është ky: një gazetë lexohet për t'u harruar edhe disku dëgjohet për t'u harruar, është një gjë mekanike dhe kuptohet që është e përkohshme. Porse një libër lexohet për t'u kujtuar.

Koncepti i një libri të shenjtë, si Kurani, si Bibla apo Vedat - që shkruajnë se edhe ato e kanë krijuar botën - është ndoshta i tejkaluar, por libri ruan përherë një shenjtërim, të cilin duhet të përpiqemi të mos e humbim. Të marrësh një libër e ta hapësh, e bën edhe më të mundshëm faktin estetik. Cilat janë fjalët që flenë në libër? Ç'janë ato simbole të vdekura? Krejtësisht asgjë. Çfarë është një libër që nuk e hapim? Është thjesht një kub letre apo lëkurë, me fletë; por nëse e lexojmë do të ndodhë diçka e çuditshme. Dhe besoj se libri ndryshon sa herë që e lexojmë.

Herakliti thotë (e kam përsëritur shpesh) se njeriu kurrë nuk lahet dy herë në të njëjtin lumë. Ne nuk lahem kurrë në të njëjtin lumë, sepse ujërat e tij ndërrojnë. Akoma më e tmerrshme është se edhe ne jemi ujqorë si lumi. Sa herë që lexojmë një libër, aq herë ndryshon ai, ngjyrimi i fjalëve nuk është i njëjlojtë. Sepse librat janë mbrytur me të shkuar.

Kam folur kundër kritikës dhe po e përgënjeshtroj veten (ç'rëndësi ka që përgënjeshtrohem?). Hamleti nuk është saktësisht ai Hamlet që krijoi Shekspiri në fillimet e shek. XVII; Hamleti është Hamleti për të cilin flet Kollrixhi, Gëteja dhe Bredli. Hamleti është rikrijuar. E njëjta gjë ka ndodhur me Don Kishotin. Kjo mund të thuhet edhe për Lugones apo Martinez Estrada. "Martin Fierro" nuk është më ai që ka qenë. Lexuesit pak nga pak e kanë pasuruar librin.

Kur lexojmë një libër të hershëm, është një lloj si të përshkonim kohën që ka kaluar që nga çastet kur ai është shkruar e deri në ditët tona. Ja përse duhet të kemi kultin e librit. Një libër mund të jetë plot gabime shtypi, ndodh edhe që të mos jemi dakort me atë që thotë autori, por libri ka diçka të shenjtë dhe hyjnore. Nuk duhet ta respektojmë atë, të shtyrë nga bestytnia, por me dëshirën e madhërishtme që të kridhemi në lumturi e në dije.

Kjo është ajo që doja t'ju thosha sot.

(Ligjëratë e mbajtur nga autori me studentët e Universitetit të Belgranos, Buenos-Aires, 1977.

Përktheu nga frëngjishtja: Feride Papeleka)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së vlerëson pozitivisht garat e Kampionatit të Kosovës



PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka mbajtur mbledhjen e radhës nën drejtimin e presidentit Agim Ademi, në të cilën ka shqyrtuar shumë çështje me rëndësi për futbollin e Kosovës.

KE në këtë mbledhje ka analizuar rrjedhën e garave të Kampionatit të Kosovës dhe ka konstatuar se ato kanë rrjedhë normale sipas orarit dhe dinamikës së paraparë. "Është konstatim i të gjithëve se ka një ngritje të cilësisë, si në organizim, lojën në fushë, sjelljen e futbollistëve dhe ndarjen e drejtësisë, që kampionatin po e bën mjaft joshës, interesant me një rivalitet të madh sportiv. KE do të jetë i angazhuar maksimalisht që mbarëvajtja e garave të shkojë deri në fund ashtu si duhet, ndaj u bënë thirrje klubeve, gjyqtarëve e vëzhguesve që të jenë në nivelin e detyrave dhe përgjegjësi dhe gjithë faktorëve të tjerë relevantë me besim të plotë që të jenë, po ashtu, të angazhuar në nivelin më të lartë, që të kemi një përfundim të suksesshëm të kampionatit", është thënë në

njoftimin për media të Federatës së Futbollit të Kosovës.

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së ka bërë me dije se nuk do të lejojë asnjë tendencë që shkon në dëm të mbarëvajtjes së garave dhe që dëmton dhe prish imazhin e futbollit të Kosovës. Në këtë mbledhje është folur edhe për njëvjetorin e vdekjes së legjendës së futbollit dhe ish-presidentit të FFK-së, Fadil Vokrri. "Meqenëse po afrohet njëvjetori i vdekjes së legjendës së futbollit dhe ish-presidentit Fadil Vokrri, KE mori vendim dhe themeloi komisionin për rregullimin e varrit. Kështu që, Komisioni i përbërë nga Agim Dibrani, kryetar, Arianit Ahmeti, Ilaz Mjaku e Mirsad Çollaku - anëtarë, do të përkujdesen për mbarëvajtjen e punimeve të varrit të ish-presidentit. Po ashtu, KE në datëlindjen e legjendës Fadil Vokrri më 23 korrik do të organizojë një turne përkujtimor në kategorinë e veteranëve të kohës dhe brezit të Fadil Vokrrit, e ku do të marrin pjesë veteranët e klubeve, në të cilat ka luajtur legjenda, Llapi, Prishtina, Partizani dhe Fenerbahçe. Për këtë turne dhe

mbarëvajtjen e tij KE themeloi komisionin në përbërje Bakir Buri, kryetar, Jusuf Tortoshi e Luan Salihu, anëtarë", është thënë në këtë njoftim.

Po në këtë mbledhje KE-ja vendosi edhe për hartimin e strategjisë zhvillimore të FFK-së për periudhën 2020-2024, në përputhje edhe me kërkesat e UEFA-s për hartimin e strategjisë të federatave kombëtare. "Për hartimin e kësaj strategjie do të përkujdesen presidenti Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu bashkë me shefat e sektorëve në FFK si dhe do të angazhojë ekspertë të fushave në mënyrë që strategjia të jetë sa më profesionale dhe gjithëpërfshirëse. KE-ja shqyrtoi dhe analizi edhe agjendën e grumbullimeve të ekipeve kombëtare dhe mori vendim që të gjitha agjendat e punës së kombëtareve të jenë në përputhje me racionalitetin dhe nevojat e duhura në përputhje me objektivat e secilës kombëtare. Po ashtu, KE shqyrtoi edhe kërkesat dhe parashtratat drejtuar këtij organi", është thënë në njoftimin për media të FFK-së.

SHKURT

Interes i shtuar për gjysmëmaratonën e Prishtinës

Federata e Atletikës e Kosovës së bashku me Komunën e Prishtinës kanë bërë të gjitha përgatitjet për gjysmëmaratonën e cila do të mbahet këtë të diel. Në regjistrimet për të marrë pjesë në këtë gjysmëmaratonë shihet një interesim i madh nga qytetarët. Këtë e konfirmoi edhe sekretari i Federatës së Atletikës së Kosovës, Abdurrahman Shkodra, i cili tha se nuk mungojnë edhe atletët nga jashtë vendit. Këtë vit do të ketë disa risi në gjysmëmaratonën e Prishtinës që nga medaljet e deri tek organizimi. Gara e vitit 2019 do të mbahet të dielën, duke filluar nga ora 10:00, e cirkuiti i saj do të jetë i njëjtë si në vitin e kaluar, me një gjatësi prej 21 kilometrash.



Klubet italiane dhe gjermane shprehin interesim për Vedat Muriqin

Me 13 gola dhe shtatë asistime në këtë sezon, Vedat Muriqi ka luajtur një rol të rëndësishëm në ngjitjen e Rizesporit në Superligën turke nga vendi i fundit në të shtatin. Për sulmuesin e përfaqësueses së Kosovës interesohen disa prej klubeve më të mëdha të Turqisë, madje Fenerbahçe ka bërë një ofertë zyrtare për ish-lojtarin e Teutës dhe Besës. E sigurt është që në verë Muriqi do të ndërrojë skuadër, por pritet të shihet se ku do të qëndrojë e ardhmja e tij, raporton 'SuperSport'. Nga ana tjetër, nuk përjashtohet as mundësia që futbollisti i Kosovës të transferohet në një tjetër kampionat, pasi duke iu referuar deklaratave të agentit të futbollit për mediat turke, sulmuesi kërkohet edhe në Itali e Gjermani. Në afatin kalimtar veror pritet që Vedat Muriqi ta bëjë hapin e madh në karrierë.



Katër skuadra ndjekin mbrojtësin e majtë të Fiorentinës

Milan, Inter, Roma dhe Paris Saint Germain janë katër skuadrat që kanë kërkuar informacion zyrtar për transferimin e mbrojtësit të Fiorentinës, Cristian Biraghi. I rritur në akademinë e Interit, mbrojtësi i majtë po luan mjaft mirë me klubin vjollcë dhe ka merituar edhe thirrjen e Mançinit në kombëtaren italiane. Mbrojtësi i majtë 27-vjeçar kushton rreth 10 milionë euro dhe ka përvojën e duhur për të përballuar sfida të mëdha, ndaj shihet si një mundësi e artë që ofron merkatoja.



Renato Sanchezi paralajmëron largimin nga Bayerni

Mesfushori portugez Renato Sanchez ka paralajmëruar largimin nga Bayerni i Mynihut në fund të sezonit, pasi nuk është i kënaqur me minutazhin e aktivizimit. "Mendoj se do të largohem në fund të sezonit, por nuk mund të them nëse do të jetë një lamtumirë, apo huazim. Kam nevojë të luaj, për t'u rritur dhe këtu nuk po gjej hapësira mjaftueshëm", ka thënë futbollisti portugez.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Anova" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330394255.

► "Ordino" SH.P.K shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71120775 nr. fisk. 601197553 si dhe nr. e TVSH-së. 330253302.

► Liridona Makolli shpallë të pavlefshme tri dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme Ekonomike Llabjan.

► D.P.T. "AS" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70534479 nr. fis. 600604187.

► Florije Karpuzi, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Idriz Ajeti" në ish-Sadllar, tash Shalë në Lipjan.

► Drenusha Rrustemaj shpall te pavlefshme diplomën + 3 dëftesat e shkollës se mesme gjimnazi "Hamëz Jashari" Skenderaj.

► Lumturije Asllani shpall te pavlefshme diplomën + 3 dëftesat e shkollës se mesme gjimnazi "Hamëz Jashari" Skenderaj.

► Shpejtim Azizaj shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

Ilirijana Dida shpall te pavlefshme diplomën SHMPT "12 Marsi" Prizren

► Sheriban Sunduri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII Shf "Leke Dukagjini" Prizren.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Glllogoc
Zyra e Personelit
01Nr. MM/01-21523 dt. 23/04/2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Glllogoc/Drenas, shpallë:

KONKURS PUBLIK
Për pozitën : Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari

Emri i institucionit rekrutues: Komuna Drenas/Glllogoc
Nr.referencës: RN00004740
Pozita e punës: Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari
Institucioni: Drejtoria e Infrastrukturës Publike
Divizioni/njësia: Sektori I Ndërtimit
Lloji i pozitës: I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës: Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit: Drejtori
Kategoria Funktionale –Grada: Niveli Profesional, grada 8, Koeficienti 7
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit: Po
Procedura e Aplikimit: I Jashtëm
Numri i kërkuar: 1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit: I përhershëm
Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 8, Koeficienti 7, Drejtoria e Infrastrukturës Publike.

Detyrat Kryesore:

- Zhvilloj dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike hartimin e paramasave, mbikëqyrjen profesionale, pranimin e projekteve;
- Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Bën hartimin e paramasave dhe paralogarive për projekte për nevoja të institucionit;
- Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
- Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësive organizative;
- Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor: (aftësitë, përvoja si dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës): Diplomë universitare: Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës- Drejtimi Hidroteknik, 3 vite përvojë pune profesionale, Njohuri dhe përvojë substanciale në lëminë e ndërtimit, Aftësi komunikuese, negociuese, Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë, Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, AutoCad);

Vendi ku mund të merrën dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kat i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.
Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje të noterizuara dhe nuk kthehen.
Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.
Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, çertifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kriterëve të konkursit.
Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data 23/04/2019 deri më 07/05/2019, për pozitën e cekur më lart.
Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqes së komunës dhe shpalljes në hyrje të komunës.



Udhëheqëse e Personelit
Hanumshahe Shabani



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Glllogoc
Zyra e Personelit
01Nr. MM/01-21528 dt. 23/04/2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Glllogoc/Drenas, shpallë:

KONKURS PUBLIK
Për pozitën : Zyrtar për Menaxhimin e mbeturinave

Emri i institucionit rekrutues: Komuna Drenas/Glllogoc
Nr.referencës: RN00004739
Pozita e punës: Zyrtar për Menaxhimin e mbeturinave
Institucioni: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
